LIGJ
Nr.10 462, datë 13.9.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9718, DATË 19.4.2007 "PËR URDHRIN E INFERMIERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9718, datë 19.4.2007 "Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, pas fjalës "fizioterapeft" shtohen fjalët "teknik/e laboratori, teknik/e imazherie, logopedist/e".

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 2

Ky ligj e shtrin veprimtarinë e vet në të gjithë territorin e vendit dhe zbatohet për të gjithë infermierët/et, mamitë, fizioterapeftët/et, teknikët/et e laboratorit, teknikët/et e imazherisë dhe logopedistët/et, që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë.".

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 3

Urdhri i Infermierit është ent publik jobuxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesioneve të infermierit/es, mamisë, fizioterapeftit/es, teknikut/es të/së laboratorit, teknikut/es të/së imazherisë dhe logopedistit/es, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut.".

Neni 4

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikat 1, 2, 3 dhe 4, pas fjalëve "infermierët dhe mamitë" shtohen fjalët "fizioterapeft/e, teknik/e laboratori, teknik/e imazherie dhe logopedist/e".

2. Në pikën 5 dhe në të gjitha nenet e tjera të ligjit fjalët "mami, infermier ose fizioterapeft" zëvendësohen me fjalët "infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laboratori, teknik/e imazherie dhe logopedist/e".

Neni 5

Në nenin 12 pika 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
1. Fjalët “17 anëtarë” zëvendësohen me fjalët “21 anëtarë”.
2. Pas shkronjës “dh” shtohen shkronjat “e”, “ë” dhe “f” me këtë përmbajtje:
“e) dy përfaqësues të shoqatës së pacientëve;
ë) një përfaqësues i sindikatës së infermierëve;
f) Zëvendëspresidenti i Urdhrit të Infermierit të Tiranës.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7088, datë 27.9.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi